



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK  
ELBASAN**

Nr 340 Prot

Elbasan më 09.05.2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë "; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 " Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive " ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 " Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarivë te ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional",ne Urdherin nr. 22, date 27.01.2023 " Per miratimin e numrit te Instruktove dhe Mesuesve me kohe te pjesshme per vitin 2023"

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofritit Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Instruktor/e Kujdestar Social – 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në profesionin e kursit të formimit profesional për të cilin po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

#### Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të përfshijë:
  - letermotivimin për pozicionin;
  - jetëshkrimin ( CV-në)
  - kartën e identitetit
  - diplomë
  - librezë e punës
  - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
  - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
  - vërtetim të gjendjes shëndetësore
  - vërtetimin të gjendjes gjyqësore
  - vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
  - rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
  - dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
2. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin të ofrimit publik të AFP-së brenda datës 24.08.2023

**DREJTOR**

**Krenar XHEMALI**

